

PROCESVERBAL X /2025

I mbajtur me rastin e mbledhjes së 10 (dhjetë) për vitin 2025 të Kuvendit të Komunës së Suharekës

Vendi:	Suharekë
Zyra:	Salla e Kuvendit të Komunës
Data:	30.10.2025

Prezentë në takim:

Z. Shefket Kolgeci	Z.Vullnet Luzhnica	Të pranishëm tjerë:
Z.Selman Kolgeci	Z.Edon Sadikaj	Kryetari Komunës
Z. Flamur Bytyçi	Znj.Saranda Bajraktari	Media dhe qytetarë
Z. Urim Suka	Znj.Mimoza Bajraktari	OSCE, LMT, KDI
Z. Kushtrim Kuçi	Znj.Festë Kabashi	Znj.Habibe Bytyqi
Znj. Elmaze Bytyqi	Z.Dardan Berisha	Z.Xheladin Sadikaj
Znj. Bulëza Kuçi	Z.Bajram Basha	
Znj.Doruntina Zenelaj	Znj.Mevlude Kabashi	
Z.Alban Berisha	Znj.Sheqerije Zyrapi	
Z. Xhevshet Gashi	Znj. Afërdita Morina	
Znj.Sanie Kuçi- Rexhepaj	Znj.Laureta Tafaj	
Z. Bexhet Kuçi	Z.Liridon Fandaj	
Z. Lirim Qatani	Z.Qëndrim Elshani	
Z. Aziz Bytyqi	Z. Reshat Selimaj	
Znj.Fidaije Kukaj	Z.Herolind Limaj	
	Znj.Jehona Lumi	
	Rrafshi	

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi, Kryesuesi i Asamblesë Komunale z.Bexhet Kuçi,i cili propozoi këtë:

REND DITE

1.Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar ;

2.Shqyrtimi i projekt-vendimit për caktimin e normave tatimore për tatimin në pronën e paluajtshme për Komunën e Suharekës;

3.Shqyrtimi i projekt-vendimit për shfuqizimin e Rregullores 01-Nr-016-56044;

4. Informatë financiare për administrimin e buxhetit të komunës së Suharekës për periudhën janar-shator 2025;

5.Raporti i performancës për komunën e Suharekës për periudhën janar-dhjetor 2024;

6.Pyetje dhe përgjigje;

Kryesuesi - e hedh në votim rendin e ditës.

Unanimisht Miratohet

Pika 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 1.

Unanimisht Miratohet

Pika 2. Shqyrtimi i projekt-vendimit për caktimin e normave tatimore për tatimin në pronën e paluajtshme për Komunën e Suharekës;

Kryesuesi - e elaboron pikën dhe hap debatin.

Avni Bytyqi - në vitin 2023 Kuvendi i Kosovës e ka miratuar plotësim-ndryshimin e ligjit për tatimin në pronë dhe i ka dhënë mundësi komunës që ta rishqyrton normën tatimore.Në vitin 2025 DEFB e ka inicju këtë procedurë,projekt-vendimin e kam hartu unë si zyrë ligjore dhe pas analizimit të të gjitha këtyre çështjeve kemi ardhë në përfundim që norma tatimore të caktohet në minimum prej 0.10 % të vlerës siç është parapa ligji te tatimi në pronë.Besoj që është interes i qytetarëve dhe i gjithë përfaqësuesëve këtu që ky projekt-vendim ta merr aprovimin.

Labinot Halitjaha - ne sot kemi sjell një dokument për ndryshimin e normave tatimore në komunën e Suharekës ku koeficienti për llogaritjen e pronave në komunën e Suharekës deri këtë vit ka qenë 0.15% në bazë të vlerës së vlerësuar të çdo prone.Ne nuk e kemi sjell deri këtë vit për shkak të ndryshimit të ligjit të ministrisë të cilën e dha qeveria për zbritjen e tatimit në pronë deri 100 euro dhe këtë vit e kemi sjell si propozim që norma tatimore të zvogëlohet nga 0.15 % në 0.10% në komunën e Suharekës.Drejtori tutje jep sqarime.

Liridon Fandaj - ne e kemi diskutu edhe në KPF dhe kam kërku sqarim që norma,a ka me qenë e përgjithshme apo ka me qenë zona,dhe zyrtari ligjor ka thënë që në bazë të rregullores është e përcaktuar me zona.Drejtor a ke bërë një kalkulim sa ndikon kjo normë në buxhet? dhe vlerësimi i pronave nëpër zona,a bëhet në ministri apo bëhet në Drejtorinë për Ekonomi dhe Financa?

Labinot Halitjaha - vlerësimin e pronave dhe të objekteve e bën ministria në bashkëpunim me komunën por në fund vendos ministria,vetëm nëse kemi ankesa apo probleme ku ne e shohim që duhet të bëhet ndryshim i vlerës së pronave komerciale,tokave dhe objekteve të banimit.Komuna e Suharekës është e ndarë në 6 zona ku pjesa e qendrës është pjesa më e shtrenjtë dhe në zonat më malore vlera është më e vogël.

Urim Suka - ne këtë projekt-vendim që ka ardhë po e shohim si mundësi që komuna e ka për me kriju lehtësi te qytetarët që tatimi në pronë për të gjitha këto njesi të jetë më i lirë.Ne i japim

mbështetje dhe mendojmë që ju si drejtori duhet të jeni të kordinuar mirë me ministrinë që vendimet që i marrim,të jenë sa më të mira dhe mos të kemi vështirësi apo lajthitje si asamble.

Flamur Bytyçi - mendoj që ky vendim nuk është në rregull për shkak që nuk mundet me u krahasu një njesi bujqësore parcelë me një objekt rezidencial.Kur e shohim faturën e tatimit në pronë për vitin 2024 për komplet fshatin Delloc,fatura e tatimit në pronë është 88.20 €.A mund të sqarosh,sa e paguan dikush në zonën 4 dhe zonën 5?Sa paguan tatim një shtëpi 140m²?

Labinot Halitjaha - unë e kam sjell si propozim dhe vendimin e merrni ju.

Flamur Bytyçi - unë propozoj me shty këtë vendim dhe me bo në një formë tjetër për shkak se deri tash me këtë vendim paguajnë deri te zona e tretë.Po flas për objektet 140 m²,të tjerët nuk paguajnë asgjë me vendimin që e ke sjell.Duhet të konsultoheni bashkë,me shiku çështjen e borgjit që e ke e që është milionësh.Ligji thotë me pas trend progresiv dhe këtu s'ka trend progresiv.

Avni Bytyqi - sa i përket kalkulimeve se sa i takon tatimi në pronë një objekti,nuk është kompetencë e komunës me përcaktu këtë kalkulim,është kompetencë ekskluzive e Ministrisë së Financave (Departamentit të tatimit në pronë), ndërsa plotësim-ndryshimi i ligjit dhe ligji bazik i tatimit në pronë i ka dhënë kompetencë dhe mandat komunës vetëm që ta cakton vlerën e norms tatimore. Zyrtari ligjor tutje jep sqarime.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 2.

25 për,1 kundër,Miratohet pika 2

Pika 3. Shqyrtimi i projekt-vendimit për shfuqizimin e Rregullores 01-Nr-016-56044;

Kryesuesi - e elaboron pikën dhe hap debatin.

Selman Kolgeci - shfuqizimi i kësaj rregullore është një procedurë e zakonshme që jemi mësu fatkeqësisht me na ardhë.Ky akt është dëshmia më e qartë e mashtrimit të pushtetit në largim,një mashtrim që sot vulozet edhe me dokumente zyrtare.Ajo që ne kemi paralajmëruar për 4 seanca me radhë,sot vërtetohet se ne kishim të drejtë.Në vzhdimësi është tentuar nga pushteti që ne përfaqësuesit e opozitës të paraqitemi para qytetarëve si bllokues të zhvillimit dhe kundërshtar të progresit,por sot faktet flasin vet.Ne ishim ata që mbrojtëm interesin publik,profesionalizmin dhe zbatueshmërinë ligjore të rregullores.Ne dhamë kontribut real që kjo rregullore të jetë e qartë,e zbatueshme në përputhje me HZK-në në mënyrë që të mundësonte zhvillim të qëndrueshëm të qytetit.Në anën tjetër qëllimi juaj ishte krejt tjetër,mashtrim para qytetarëve dhe para ndërtuesve.Për faktin që ministria e ka kthyer prap edhe për çështje të monitorimit ,në vitin 2023 kemi kërkuar raport për monitorimin e HZK-së por nuk e kemi marrë për bazë dhe në vitin 2024 prap kemi kërku raport për monitorimin e HZK-së por prap nuk e kemi marrë për bazë.Ne i kemi lexuar letrat e juaja që i kemi fsheh në gjep dhe e kemi dikur që rregullorja juaj nuk qëndron as teknikisht e as ligjërisht.Sot kur dëmi është bërë,kërkojmë përgjegjësi.Kërkoni sot falje bizneseve,ndërtuesve të Suharekës,asambleistëve të opozitës,e shumë familjeve dhe çdo qytetari të kësaj komune që është mashtruar dhe dëmtuar nga paafësia e kësaj qeverisje.

Sanie Kuçi Rexhepaj - sot po e diskutojmë një dokument që më shumë ka prodhuar konfuzion se sa zhvillim,më shumë ka prodhuar propaganda se sa planifikim,më shumë është shfrytëzuar për politikë e sulm ndaj disa individëve të LDK-së se sa përfitim për qytetarët.Në 4 mbledhje radhazi kuvendi është vendosur përballë të njëjtit material.Në maj është sjell për herë të parë,nuk kaloi.Në qershor është sjell e njëjta rregullore,prap nuk kaloi.Në korrik është sjell e njëjta rregullore dhe pa u përfshi asnjë rekomandim që ka dal nga ky kuvend por prap nuk kaloi.Në gusht u sjell e njëjta rregullore,pa asnjë ndryshim dhe fatkeqësisht u miratua.Tash në tetor po e diskutojmë prap të njëjtën,të kthyer tash më nga ministria për shfuqizim pasi është në kundërshtim me HZK-në dhe me ligjin për planifikim hapsinor.Ky dokument duhet të shfuqizohet sepse nuk mund të qëndroj në fuqi më por fatkeqësisht komunës i duhet edhe shumë kohë për me hartu një rregullore të re të bonuseve të zonimit në përputhje me ligjin.Lexon dhe interpreton vendimin e ministrisë.Ka 4 vite që PZHK ka hy në fuqi dhe 3 vite që HZK ka hy në fuqi,kuvendi jonë asnjë vit nuk e ka shqyrtu raportin e monitorimit të zbatimit as të HZK-së dhe as të PZHK-së sepse ky ekzekutiv nuk e ka sjell asnjëherë në kuvend atë raport,as nuke ka përgadit dhe ndoshta as nuk janë të aftë me përgadit një raport të tillë.Për këtë arsye edhe e

thash që komunës i duhet shumë kohë për me hartu një rregullore të re në përputhje me ligjin sepse kemi hendikep për mosmonitorimin e PZHK-së dhe HZK-së. Ju jeni dëshmitar që nga seancat e para të kësaj qeverisje sa herë e kam cek dhe sa herë e kam kërku raportin me u sjell në kuvend. Asnjëherë si raport që po e kërkon Sania por si raport që po e kërkon ligji. Si pasojë e mosraportimit, jo transparencë dhe jollogaridhënies ndër vite, sot ministria nuk na kalon asnjë dokument tjetër të bazuar në HZK se po na thotë: ju nuk keni raportin dhe si po zbatohet HZK-ja andaj s'mund të hartoni dokumente të reja mbi bazën e saj. Lexon nenin 11 paragrafi 1.14 që e ka cek ministria në vendim. I njëjti raport duhet me shku në suaza vjetore si informim në ministri sepse kështu e kërkon ligji. P.sh. nëse komuna në dhjetor të viti të kaluar ashtu siq e parasheh edhe plani i punës së këtij kuvendi kish raportin rreth zbatimit të HZK-së në kuvend dhe në njërin ndër pikat kish me cek: komuna ka vështirësi në realizimin e rrugëve të planifikuara sepse për tu realizuar rrugët sipas standarteve dhe normave teknike të planifikimit hapsinor në HZK ato janë planifiku pjesërisht në pronë private, me ç'rast pronarët e tokave nuk po mundën me i shfrytëzuar 100% të tokave të tyre në njërin anë dhe komuna ka buxhet të kufizuar për shpronësimin e këtyre pronave në anën tjetër. Me këtë fjali komuna kish raportin në kuvend që HZK-ja nuk po mundet me u realizu në këtë çështje dhe kish pas të drejtë me hartu dhe me miratu një rregullore për bonus zonim sepse ia lejon HZK-ja dhe arsyetimi i komunës tash më kish me qenë i raportuar në kuvend dhe ministria për këtë çështje kish me qenë e informuar. Nuk kemi as informatë, as llogaridhënie, as transparencë por kemi vetëm neglizhencë dhe injorim të këtij kuvendi e për këtë neglizhencë dhe injorim po ndëshkohen shumë investitorë dhe shumë pronarë të tokave. Kur ne flisnim për këmbim prone të planifikuara, për rrugë me m² ndërtim, në rregullore u diskutojke edhe liri nga taksat, rregullimi i infrastruktures nga vet investitorët dhe në komision u përfshi një vlerësues i pronave që nuk e dinim saktësisht se cili është roli i tyre por në anën tjetër komuna hezitojke me përfshi në të njëjtin komision një asambleist të këtij kuvendi për me pas transparencë dhe bashkëpunim dhe kësaj çështje ministria i tha stop. Pika tjetër që ka cek ministria është që komuna ka përdorur një tabelë informative të ofruar nga vet ministria për sqarim e jo për përdorim në rregullore të së njëjtës. Tejet qesharake këtë çështje me ta cek ministria në një vendim zyrtar. Së fundi ka inkurajuar komunën që të zbatoj dhe të monitoroj në mënyrë meritore dhe transparente zbatimin e dokumenteve në fuqi. Për fat të keq pasojat e mosraportimit po i shohim sot. Shfuqizimi i kësaj rregullore nuk është pengesë për zhvillim, është hap i drejtë, drejt ligjshmërisë dhe profesionalizmit. Ky mandat do të mbahet mend për numrat rekord të vendimeve të kthyera nga ministria si vendime në kundërshtim me ligjin fatkeqësisht.

Laureta Tafaj - ky shfuqizim tregon që kjo qeverisje në Suharekë asnjëherë nuk ka vepruar në të mirë të qytetarëve por gjithmonë vetëm për interesat personale e sidomos për interesat e Kryetarit aktual. Andaj fatkeqësisht ose fatmirësisht për vendimet e pamatura të kësaj qeverisje po duhet me mendu ma shumë ministrinë edhe qeveria se sa vet ju.

Urim Suka - nuk dua ti shtoj asgjë asaj që thanë dy kolegët e mi nga grupi jonë i asambleistëve të cilët në mënyrë profesionale e paraqitën atë që ka ndodh me këtë rregullore por dua ti them disa çështje nga rruga se si kemi ardhë deri te ky projekt-vendim. Një prej arsyeve kryesore kur ne kërkonim që kjo rregullore të plotësohej dhe ndryshohej, arsyetimi juaj ishte që këtë rregullore e kemi koordinu me ministrinë dhe po të bëhen plotësime dhe ndryshime në kuvend, kemi frik që kthehet nga ministria. Në fakt i bie që ju nuk jeni koordinu asgjë me ministrinë sepse kjo veq është kthyer nga ministria. Kur nuk kalonte kjo rregullore, drejtori përgjegjës në një rast ka thënë: ju nuk e dini çfarë dëmi ja keni bërë bizneseve, janë shumë lëndë duke pritur nëpër sirtar që kjo rregullore të miratohet dhe ata të përfitojnë. Ato lëndë që kanë pritur nëpër sirtar, pse kanë ardhë? Ku e kanë ditë ata? Ju i keni përdorur krejt ato biznese por në anën tjetër, sot nuk e kemi këtë rregullore. A e dini sa here e kemi kërku raportin e HZK-së me ardhë në Kuvend? Një prej arsyeve kryesore pse nuk ka kalu është pse nuk keni raportin kurrë. E sot krejt ato biznese dhe ata qytetarë nuk mund ta gëzojnë këtë rregullore sepse ju keni hargju energji për me bo propaganda e nuk keni hargju energji për me bo një rregullore siq nuk po hargjoni energji për shumë vendime që po kthehen.

Alban Berisha - Kryesues 4 seanca na keni bërë ftesë me votu këtë rregullore. Tash, çfarë ftese po na bëni? A me votu shfuqizimin? Po e shoh që votat s'i keni me shfuqizu, a ju duhet ndihma jonë apo jo?

Kryesuesi - unë e kam sjell sipas ligjit në fuqi që duhet me sjell brenda 30 ditësh.

Alban Berisha - nëse ne nuk e votojmë shfuqizimin, i bëhet dëm i madh qytetarëve sepse shkon kohë deri të shqyrtohet qysh e ka kërku ministria.

Visar Kuçi - unë nuk dua të merrem me ata që bënë politik për këtë vendim por dua ta njoftoj opinionin e gjerë. Paraprakisht gjatë të gjitha seancave kam thënë që ne duhet me kry punën tonë dhe nuk e di a kalon rregullorja në ministri. Me vendim të Kryetarit të komunës është emëru ekipi punues i rregullores. I vetmi njeri politik ka qenë Drejtori i Urbanizmit si udhëheqës i ekipit dhe gjithë të tjerët kanë qenë profesional të të gjitha fushave, zyrtar të komunës. Kjo rregullore ka kalu me 29.08.2025. Me datë 13.09.2025 ka ardhë një plotësim lënde nga ministria ku kanë kërku me i caktu zonat ku do të përdoren rregulloret e bonuseve dhe ne ia kemi plotësu lëndën dhe çuditërisht me date 08.10.2025 jam njoftu përmes portaleve që ky vendim është kthi para se me ardhë në komunën e Suharekës. Si është e mundur një vendim me u kthi pa e pa komuna? Pajtohem me Albanin mos me shfuqizu sepse kjo rregullore i plotëson kushtet. Unë edhe sot nuk e kam këtë dokument. E kam pa në zyrën e Kryetarit, me date 13 ose 14 ka ardhë.

Liridon Fandaj - drejtori tha një të pavërtetë, ku tha që të gjitha subjektet politike kanë marrë pjesë në hartimin e kësaj rregullore. Drejtori 3 herë ose 4 herë sa nuk ka kalu rregullorja, s'ka lënë biznesit pa i thënë që Liridoni është duke e ndalu këtë rregullore. Unë publikisht e kam thënë edhe këtu që jam kundër rregullores dhe i kam dhënë edhe vërejtjet e mia. Edhe ankesën e kam dërgu zyrtarisht. Kryesuesi është arsyeu që nuk i ka shku në email. Është shumë e ulët që bizneseve ju shkon screenshots që Liridoni ka bo ankesë dhe po e bllokon. Këtë e ka bërë drejtori. Një diçka që është jo ligjore, gjithmonë ka me kërku interpretim ligjor.

Kryesuesi - dua të sqaroj që rekomandimi prej ministrisë nuk më ka ardhë mua dhe as zyrtarit ligjor. I ka ardhë me vonesë, pas afatit Kryetarit kopje fizike.

Alban Berisha - shumë shpesh i kemi të njëjtat debate kur të kalon ose nuk kalon diçka dhe ftesa për mos me bo politikë. Ne jemi këtu për politikë dhe jemi të zgjedhur për me bo politikë por jemi edhe të zgjedhur për me mbrojtë interesin qytetar. Kur të ofroni politikë, keni me marrë politikë. E them këtë sepse gjithmonë si opozitë për çdo vendim i kemi dhënë vërejtjet tona dhe ju kam thënë që mos e sillni vendim por silleni draft ta diskutojmë. Sikur të ishte gadishmëria prej anës së pushtetit për me i ndëgju propozimet tona ose me bo një grup punues, ndoshta ish kthi prap sepse edhe ne mund të kishim pas gabime por ish shfuqizu dhe kish shku në formën tjetër si po kërkon ministria dhe nuk do të ishte bërë gjithë ky debat. Është e ofruar në mënyrë politike prej juve, është e maruar në mënyrë politike dhe merr konutacion politik çdo vendim prej juve që ka ardhë këtu. Kam një këshill meqenëse po kryhet ky mandat. Ju lus, edhe Avniut si këshilltar juridik dhe pozitës kush do që vje, mundohuni me sjell draft ku asambleistat në fushë të caktuar mund të japin kontribut. Prap do të bëjmë politikë secili prej nesh por të paktën nëse po dojmë ta quajmë një vendim të përbashkët, ta japim edhe ne kontributin tonë sepse nuk kemi qenë gjithmonë bllokues. Sot ishte rregullorja për tatimin në pronë, na u duk e mirë, po përfiton qytetari dhe e votuam.

Visar Kuçi - kjo rregullore e ka pas një periudhë 15 ditësh që ka dal në shqyrtim publik dhe secili qytetar, biznes, asambleist etj kanë pas mundësinë me i dhënë vërejtjet e tyre. Drejtori tutje jep sqarime. A nuk është e ulët me dal vendimi në rrjete sociale para se me ardhë në komunë?

Alban Berisha - pajtohem që dëgjimet publike janë të rëndësishme dhe me ardhë me dhënë kontributin secili por kjo rregullore nuk është më e rëndësishme se projekt-buxhetin që e keni sjell. Nëse një asambleist e ka të drejtën këtu me bo një propozim në projekt buxhet për një rrugë ose diçka tjetër gjatë shqyrtimit ku çdo herë ka ndodh kjo, pse nuk po bëjka edhe këtu me marrë propozime shitesë? Ne jemi organi që nxjerr dokumente dhe duhet me qenë edhe organi që shqyrton dokumente dhe që jep kontributin për ato dokumente sepse në fund asnjë dokument nuk thotë që miratohet nga ana e asambleistëve të pozitës ose të opozitës por miratohet nga ana e asamblesë. Për atë që the se a është e ulët me dale në rrjete sociale, është fushat politike dhe është normale që mund të ndodhin edhe këto. Ka pas shumë gjëra të ulëta sidomos ndaj kësaj rregullore.

Urim Suka - vërejtjet kryesore që ne i thamë si ekip, ata të cilët e morën fjalën, ishte mosraportimi i HZK-së e që drejtori nuk e tha asnjë fjalë. Çështja kryesore që kjo është kthi, gati është mosraportimi.

Laureta Tafaj - si folës na u laku në një mënyrë emri. Për 4 vite drejtor nuk të kam parë asnjëherë më shumë të shqetësua se në këtë seancë. Nuk po arrij me kuptu pse paska qenë për ty kaq e rëndë? Kush po bën politikë në këtë rast, ne apo ju? Çka po aludon me këtë nëpër rrjete sociale? Thuaje troq.

Visar Kuçi - nuk kam qenë i nervozuar por shqetësohem për çdo gjë që nuk zgjidhet.

Selman Kolgeci - u çudita me drejtorin se si po provon me e mbrojtë këtë rregullore dhe çështja e insistimit të tij për me mbajtë në fuqi këtë rregullore, është kontradiktore me atë që po thotë: pse s'keni ardhë ju kur ka qenë afati 15 ditor me dhënë kontributin tuaj. Ne nuk patrollojmë nëpër webfaqe të

komunës.Keni pas mundësi me na dërgu materialin krejt asambleistave pa dallim,sa here ka debate dhe me i ftu me marrë pjesë në debat publik.Nuk e keni bërë dhe nuk i keni marrë parasysh argumentet dhe as propozimet tona.Disa herë kemi kërku monitorim të PZHK-së dhe të HZK-së dhe ju na keni injoruar.Sot,para se ti me u mbrojtë,është mire t'u kërkoj falje krejt familjeve,bizneseve,neve si asambleista.Çështja pse është publiku ky material,është pikërisht me ju tregu gjithë njerëzve që këta kanë mashtruar,këta na kanë thënë që jemi kundër zhvillimit të qytetit.Nuk kemi qenë,nuk jemi dhe nuk kemi me qenë kurrë.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 3.

Unanimisht miratohet pika 3

Pika 4. Informatë financiare për administrimin e buxhetit të komunës së Suharekës për periudhën janar-shator 2025;

Flamur Bytyçi - te shpenzimi 13460: shpenzime kontraktuese të tjera në vlerë prej 19.000€.Për çka janë shpenzuar këto mjete?Shpenzimi 13142:Akomodim për udhëtime zyrtare jasht vendit 920€ dhe mediet 240€.Për çka janë shpenzuar këto mjete?Pse nuk ke pas thirrje për subencione për individ, sportista dhe artista? Te kodi i shpenzimit 856:Ndërtimi i pullazit të stadiumit të qytetit në Suharekë në vlerë 246.000€.Unë pullaz te stadium nuk po shoh! Te shpenzimi 54177:Ndërtimi sallës së sportit në Peqan 120.000€, por sallë të sportit nuk ka.

Remzi Bajselmani - në Peqan është planifiku që të filloj salla mirëpo nuk është procedu ende dhe nuk është punu asgjë ndërsa shpenzimi ka dale për shkak të kontratës kolektive që janë tërhequr mjetet.

Flamur Bytyçi - pse nuk del ky shpenzim te taksa gjyqësore por rrin si i shpenzuar për ndërtimin e sallës së sportit?Kjo më duket mashtrim për neve.Kush e përgadit si dokument.

Remzi Bajselmani - Drejtoria e Financave me Thesarin i rregullon këto çështje.Ke të drejtë për shkak se edhe në Nepërbishtë e pash që janë shpenzuar 100.000€ pa fillu asgjë por mjetet që kanë qenë të planifikuara për aty janë marrë për kontratën kolektive,gjë që ka ndodhur edhe në disa drejtori.

Kryesuesi - e kemi diskutuar edhe në KPF dhe Liridoni ka qenë njëri prej anëtarëve që ka kërkuar sqarim nga ZKF dhe ai është zotuar që në janar e përgadit një pasqyrë financiare se cilat projekte kanë shku në gjykatë për mbarrim.

Labint Halitjaha - unë e kam vendimin e gjykatave të ekzekutuara deri me 22.10.2025 ku vlera ka marrë 2.829.000€.Kategori prej të cilave ka marrë janë: komunal 133.000€, mallra dhe shërbime 669.000€, subvencione 113.000€ dhe kapitale 1.913.000€.Çdo projekt ku keni dyshime,ju mund t'i drejtoheni drejtorit me email dhe ne kemi me ju tregu sa para kanë shku prej cilës kategori.

Flamur Bytyçi - kuptoj shqetësimin tim.Unë them a ka mundësi këto me i heq dhe mos mi sjell kështu dhe këtë 120.000 me vendos si shpenzim te taksa gjyqësore.

Labint Halitjaha - Drejtori dhe një here jep sqarime.

Abulena Kokollari - çështja është e njëjtë edhe te pullazi në satdiumin e qytetit ku për shkak të kontratës sociale janë marrë paratë nga ky kod dhe për këtë arsye figuron kështu.Sa i përket udhëtime jasht vendit,është e vërtetë.Unë kam qenë në udhëtim jasht vendit i cili ka qenë udhëtim zyrtar ku kanë qenë të ftuar drejtorat e Kulturës dhe të Arsimit të të gjitha komunave në Kosovë.Subvencionet individuale nuk janë dhënë për shkak të kontratës kolektive ku përmbartuesi i ka marrë paratë.Unë ndihem më së shumti keq që s'kam mujt me shpërnda subvencione individuale.

Flamur Bytyçi - ju po ankoheni që i ka marrë por ju i keni 70.000€ për shpenzime dreka-darka e skenat mujt me boqare pa artist.

Abulena Kokollari - subvencionet janë kategori në vete dhe nëse i kishim marrë prej mallra dhe shërbimeve do t'i kishim bërë keqmenaxhim.

Labint Halitjaha - nuk janë dreka-darka ato që i kanë zyrtaret komunal ose ekzekutivi por këto janë dreka-darka dhe festa që ndodhin në komunën e Suharekës prej fillimit të vitit.

Urim Suka - kohën e fundit jemi t'u e diskutuar shumë çështja e votave por ata që janë votu më së shumti sot nuk i kemi disa në sallë,këta të pushtetit.Ju mundeni edhe 20.000 vota me i marrë por për 4 vite unë këtu e kam thënë vetëm të vërtetën për mënyrën si keni qeverisur dhe është e vërtetë që për 5 vite janë bërë 5 kontrata dhe rruga "Dy martirët" nuk është shtruar.Sot në këtë raport që keni sjell figuron një kontratë për rrugën "Bashkimi" dhe "Esat Qarri"në Greiqec mirëpo me këtë kontratë po punohet

rruga “Dy martirët”. Ju kolegë asambleist të pushtetit nga 1000 vota ndoshta mundeni me i marrë dhe po votoni tjetër rrugë në buxhet dhe tjetër rrugë po shtrohet në teren dhe kur unë po flas, ju po heshtni dhe nuk po e mbron betimin që e keni dhënë. Unë kam tre kontrata që në fletën e parë shkruan emri i rrugës që është planifiku dhe në paramasë shkruan emri i rrugëve që janë duke i shtruar. P.sh. në Delloc është e planifikuar rruga “Burimi i fshatit” me kontratë, po shtrohet rruga “Elez Isufi dh rr. Dielli” ndërsa paradoksi është që rruga “Elez Isufi” figuron edhe në vitin 2026. A po kuptoni çka po ndodh? Deri sa unë po vrapoj për të vërtetën, pushteti po vrapon për propagandën dhe fatkeqësisht unë bashkë me ju po jetojmë në një kohë kur propaganda po e mund të vërtetën. Këto që thashë janë një pjesë shumë e vogël e gjithë gabimeve që ndodhin në planifikimin e në realizimin e secilës kontratë. Andaj para se të mendoni për propagandën, lexoni këto dokumente para meje, përirësoni, planifikoni drejt e realizoni sipas planifikimit dhe na jepni mundësinë të flasim për cilësinë e punimeve sepse edhe cilësia e punimeve lë shumë për të dëshmuar. Ky raport po dëshmon që ju keni dështuar të përmbushni planifikimin dhe realizimin e projekteve, jo vetëm për faktin që një pjesë i ka marrë përmbaruesi por edhe për gjithë këto probleme që ju vet po i shkaktoni me keqplanifikimin dhe devijimin e projekteve në teren. Ne do të përcjellim realizimin e buxhetit deri në fund dhe do ti adresojmë secilin shqetësim që e shohim, jo thjesht për të kritikuar por me shpresën që do të ndryshoj.

Liridon Fandaj - edhe unë kam kërku që edhe në Asamble sot me sjell një raport. Ndoshta për neve është e kuptueshme por për dikënd tjetër nuk e di, sepse ai raport publikohet dikund dhe me thënë që në Peqan është bërë palestra e aty asnjë shenjë nuk është bërë. Ai raport është dasht të na vijë për këtë tre-mujor sepse për këtë tre-mujor po diskutojmë sot.

Pika 5. Raporti i performancës për komunën e Suharekës për periudhën janar-dhjetor 2024;

Kryesuesi - elaboron pikën dhe hap debatin.

Urim Suka - unë nuk i besoj fare këtij raportit dhe më më vje keq për mënyrën se si e përgadit këtë raport ministria. Te fusha 1. Shërbimet publike administrative, ti the që jemi në top listë, po të tregoj që Suhareka renditet e 28-ta prej 33 komunave. Fusha 4. Barazia në punësim, shërbime sociale dhe familje, Suhareka renditet e 16-ta. Fusha 6. Menaxhimi i fatkeqësive, Suhareka nga 100 pikë arrin 65 pikë. Te fusha 8. Hapësirat publike, Suhareka renditet e para. Te treguesit janë hapësirat publike, mirëmbajtja e tyre dhe ndriçimi. Dalim tash, e formojmë një komision dhe shkojmë i shikojmë gjithë hapësirat publike se në çfarë gjendje janë dhe gjithëashtu edhe te ndriçimi dalim bashkë dhe e shohim sa është funksional ndriçimi nëpër vendbanime. Pra, ministria i ka dhënë 100 pikë por gjendjen e dimë se si është në teren. Transporti publik, Suhareka renditet e 23-ta por transport publik ne nuk kemi fare. Fusha 12. Mbrojtja e mjedisit, renditet e 25-ta. Fusha 14. Arsimi parauniversitar renditet e 11-ta. Mendoj që secili prej nesh duhet me i marrë me ma seriozitet këto gjëra dhe secili në fushën e vet me provu me ndryshu diçka sepse ka shumë hapsirë për m'u ndryshu.

Alban Berisha - nuk jam i kënaqur edhe unë me këtë raport, sidomos në 2 pika. Mendoj që ka huqje të madhe te menaxhimi i fatkeqësive dhe mbrojtja e mjedisit. Qyteti i luleve me i marrë vetëm 60%, jam i pakënaqur dhe menaxhimi i fatkeqësive 65 % është i pakënaqur dhe për atë dyshoj shumë në këtë raport.

Pika 6. Pyetje dhe përgjigje;

Alban Berisha - i falemderoj gjithë kolegët për bashkëpunimin dhe korrektësinë. Për 8 vite sa jam në Asamble ndihem edhe krenar por edhe përgjegjës. 8 vite i kam ngrit disa shqetësime të cilat kanë has në vesh të shurdhër dhe dua ti cek edhe një herë. Më së shumti që e kam cek, është që të kontrollohen autobusat që ecin nëpër qytet të cilët vërtetë rrezikojnë sigurinë publike sepse 10-15 orë nuk ecet nëpër qytet dhe për këtë është edhe inspektoriati i komunës. Shqetësimi i dytë ka qenë gjithmonë shitja e fishekzjarreve. Po i ofrohemi Vitit të Ri dhe vend e pa vend, pa kurrëfar kontrolli, cila moshë blen, si shiten, është çdo gjë katrahurë kur të vje Viti i Ri. Të bëhet shitja në mënyrë të kontrolluar, shitje prej personave të autorizuar sepse e kam cek që vetëm barnatoret nuk kanë shit fishekzjarre vitet e fundit. Shqetësimi tjetër është vendosja e shtëpive në shesh ku qytetarët nuk mund ta shfrytëzojnë sheshin sepse aty është e pamundur të kalohet, sidomos për nënat me fëmijë. Shqetësim tjetër është për

nxënësat e shkollës teknike në Zonën Industriale.Kam kërku që në KKSB me u marrë vesh me policinë dhe në një orar të caktuar të kontrollohen nxënësat kur ta kalojnë rrugën.Nuk e di pse duhet me ndodh një diçka me fatalitet për me marrë masa.Këto janë pikat që më kanë shqetësuar më së shumti dhe nuk ndihem krenar me punën time sepse në asnjërin prej tyre nuk kam mund të kontribuoj diçka për me ndryshu.Ju uroj suksese kolegëve të sapozgjedhur.

Shefket Kolgeci - menaxhmi i projekteve të komunës a bëhet prej inxhinierëve të komunës apo ka ndodh një firmë që ka një grup inxhinierësh dhe nuk janë nga komuna?Kush e mbikqyri projektin e kanalizimit në Vraniq?

Labinot Halitjaha - projektet menaxhohen prej dy sistemeve.Janë inxhinierat komunal me vendim prej komunës dhe janë disa inxhiniera që i marrim me kontratë specifike të përkohshme individuale ose shpeshherë ndodh që edhe kompanitë i kontraktojmë dhe ata japin përgjegjësinë e vet.

Urim Suka - kam pyetje për Drejtorin e Bujqësisë.Kam pranë disa ankesa nga fermerët për moshapjen e thirrjes për aplikim për subvencionim të qumështit.Pse nuk është hap kjo thirrje dhe çka do të ndodh me këto subvencione? Sipas informatave ju keni bërë një thirrje publike për sera ku fermerët kanë aplikuar,pastaj e keni anuluar me pretekstin që fermerët nuk i kanë plotësuar kriteret edhe pse unë jam njoftuar që aty ka pas fermerë që i kanë plotësuar kriteret.Pas këtij anulimi ju e keni hapur një thirrje tjetër për sera dhe prap keni dështuar sepse lënda paska shkuar në OSHP.A mund të sqarohet se pse ka dështuar ky projekt dhe a pritet që këta fermer të marrin sera apo përfundimisht për këtë vit ka dështuar si projekt?

Mensur Selimaj - për subvencionimin e qumështit ka qenë problem i mjeteve sikur në drejtoritë tjera por nuk do të thotë që nuk ka me pas subvencionim të këtij viti.Kemi bërë pagesat e vitit paraprak.Nuk do të ndalemi me kaq dhe u kemi premtuar fermerëve në terren që jemi në diskutim për ta bërë 5 cent dhe pjesën që nuk e kemi dhënë do të jetë me subvencionimin e vjetër.Sa i përket serave,te thirrja e parë nuk kam informacion ndërsa te thirrja e dytë na kanë rekomanduar me shpall tender të ri dhe ne këtë vit e kemi anuluar për shkak të mungesës së mjeteve dhe për shkak se kemi qenë vonë.

Urim Suka - zotimi juaj ishte që keni mirë paguar për subvencionim të qumështit dhe nuk ka dështuar.A ki me bërë thirrje publike apo si ke me realizuar dhe a ke mjete që këtë vit me realizuar sepse jemi në nëntor dhe nuk di si do ta realizoni.

Mensur Selimaj - projektet e bujqësisë funksionojnë dhe nuk do të ndalen dhe jemi duke bërë përpjekje me gjetur fonde për me hapur thirrje për fermerët.

Labinot Halitjaha - sa i përket serave kanë qenë dy thirrje dhe një pjesë e serave është dhënë prej një organizate të huaj ndërsa në pjesën e dytë ka ndodh një gabim teknik por thirrja mund të bëhet dhe mjetet të paguhet në vitin tjetër.

Urim Suka - Drejtori i Bujqësisë tha që është anuluar si projekt ndërsa ti thekxh që janë dhënë një pjesë.

Doruntina Zenelaj - te shpërndarja e lopëve si ka funksionuar procesi i shpërnarjes?A është dashtur fermerët të paguajnë ndonjë shumë këmbim-përfitimi apo kanë qenë vetëm donacion?

Mensur Selimaj - nuk janë lopë por janë mushjtjerra.Përfituesi ka pas me bërë një pagesë prej 500€ Drejtori tutje jep sqarime.

Flamur Bytyçi - te kushtet,nuk e kam kuptuar njërin prej kriterëve që ka qenë ajo foto,çka ka nënkuptuar prej drejtorisë tuaj?

Mensur Selimaj - çdo drejtor që ka pozicion e bënë më të mirën me sjellur projekte të mira për qytetarët.Objektivi im ka qenë me sjellur mushjtjerra të reja në Suharekë.Donatori e ka rregulluar që 24 vite me fermerin në familje për shkak të arsyetimit të mjeteve që i sjell në Suharekë.Drejtori tutje jep sqarime.

Festë Kabashi - sot në këtë seancë të fundit për mua si asambleiste,po e shfrytëzoj rastin të shpreh mirënjohje të thellë të gjithë atyre që ma kanë besuar votën tash 4 vite.Falemnderoj secilin prej kolegëve për bashkëpunimin.

Liridon Fandaj - me çfarë kriteresh po pranohen fëmijët sot në qerdhen e qytetit?Çka po ndodh me shkollën e Sllapuzhanit,Samadraxhës ku ka një kohë që ti ke ushtrues detyrës?A do me shpall konkurs apo do me i mbajtur me vite këta drejtorë?

Remzi Bajselmani - qerdhja e ka rregulluar e vet e cila vje prej Ministrisë së Arsimit dhe në bazë të asaj rregullore bëhen kriteret ku aplikojnë prindërit dhe merren fëmijët në qerdhe.Sa i përket drejtorëve,në Sllapuzhan kemi shpallur konkurs 3 herë dhe aktualisht është i shpallur dhe në proces.Po ashtu në Samadraxhë është shpallur për të dytën herë dhe është në proces.

Urim Suka - është seanca e fundit dhe dua të kërkoj falje në qoftëse dikush është ndier i prekur nga ato që unë kam diskutu për këto 4 vite. Asnjëherë nuk e kam pas qëllimin kurrë me lëndu dikënd në kuptimin personal por kam pas për qëllim me zbulu pushtetin për atë që e kam mendu, që e kemi për detyrë me kriju edhe një zë opozitar. Falemderim të veçantë për bashkëpunimin që kemi pas për gjithë kolegët asambleist edhe kur jemi pajtu dhe kur s'jemi pajtu.

Kryesuesi - i uron suksese asambleistave të sapozgjedhur dhe gjithë të tjerëve.

Takimi përfundoi: 12:00

Procesmbajtësja: Dafina Haziraj



Kryesuesi i Kuvendit

Mr. ec Bechet Kuçi

